



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 SHKURT 2026**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. FEBRUARA 2026. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2026**

Rendi i ditës

1. Shënimi i 18-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Obeležavanje 18 - godišnjice proglašenja nezavisnosti Republike Kosovo.

Seancën e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.

KRYETARJA: E nderuar presidente e Republikës të Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu!
I nderuar president i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj, mirë se keni ardhur në Kosovë!
Të nderuar deputetë të zgjedhur të popullit,
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,
Të nderuara familje të dëshmorëve,
I dashuri Baca Rifat,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Drejtues e përfaqësues të institucioneve tona shtetërore,
Shkëlqesi ambasadorë dhe miq ndërkombëtarë,
Delegacion i deputetëve nga Britania e Madhe,
Deputete Alicia Kearns,
Delegacion arbëresh,
Përfaqësues nga Garda e IOWA-s, SHBA,
Mysafirë që keni ardhur nga të gjitha hapësirat e popullit shqiptar, posaçërisht për të qenë sot me ne në këtë ditë të veçantë për Kosovën dhe qytetarët tanë,
Të dashur mërgimtarë,
Të nderuar prijës fetarë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e kremtimit të 18-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës!

Tani po e intonojmë himnin dhe të gjithë ngrihemi në këmbë!

(Intonimi i himnit)

Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm, ftoj presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, për një fjalë rasti. Zonja Presidente!

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI-SADRIU: I nderuar president Begaj,
E nderuar kryetare e Kuvendit, znj. Haxhiu,
I nderuar kryeministër Kurti dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Shumë i dashur Baca Rifat,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar përfaqësues diplomatikë të shteteve mike,
Ish-presidentë e ish-kryeministra,

E nderuar Familje Rugova, Familje Jashari, familje të dëshmorëve,
Përfaqësues të institucioneve të sigurisë,
Prijës fetarë të vendit tonë,
Shumë të nderuar mysafirë nga Garda e IOWA, nga Anglia dhe nga shtete të ndryshme,
Shumë të dashur qytetarë të Republikës sonë,
18 vjet më parë, Kosova u ngrit nga vuajtja në dinjitet e nga rezistenca në shtetësi, duke
dëshmuar kështu se liria e fituar me sakrificë është e përjetshme.

18 vjet më parë Kosova u shpall shtet i lirë, i pavarur dhe sovran, duke i dhënë fund një udhëtimi
të gjatë e të dhimbshëm, por edhe duke hapur një kapitull të ri të historisë sonë kombëtare.

Pavarësia e Kosovës u fitua me mund, me gjak, me sakrificë dhe me durim shekullor. Ajo u
ndërtua nga ata që u persekutuan, u burgosën, u dëbuan, u luftuan, por asnjëherë nuk u
nënshtruan.

Sot, me respektin më të thellë përulemi para kujtimit të të gjithë atyre burrave e grave që ranë për
këtë ditë, në mënyrë që Kosova të jetë Republikë.

Në themelet e shtetit tonë qëndron vizioni i Presidentit historik, dr. Ibrahim Rugova, arkitektit të
pavarësisë së Republikës sonë. Me mençuri, durim, vizion dhe një besim të palëkundur në lirinë
dhe dinjitetin e popullit tonë, ai udhëhoqi Kosovën në kohët më të rënda, duke i dhënë kauzës
sonë legjitimitet e mbështetje ndërkombëtare si dhe shpresë të brendshme.

Historia jonë më tej është brumosur në periudhën e luftës për liri. Ajo mban emrin e
Komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij heroike dhe të gjithë burrave e grave të
Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. UÇK-ja është ideali më i madh që kanë ndërtuar shqiptarët ndër
shekuj. Ajo është zemra e rezistencës sonë kombëtare dhe përgjigjja e një populli të shtypur ndaj
një regjimi gjenocidal. Kjo luftë ishte gjithnjë e drejtë, gjithnjë e pastër dhe gjithnjë e
domosdoshme. Çdo përpjekje për ta njollosur atë, për ta relativizuar apo për ta barazuar viktimën
me agresorin, është jo vetëm e padrejtë, por edhe historikisht e pavërtetë dhe tërësisht e
papranueshme.

Krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që sot gjenden në Hagë së bashku me mijëra luftëtarë të
tjerë dhe me mbështetjen e palëkundur të popullit të Kosovës, u ngritën për liri, për dinjitet dhe
për të drejtën e patjetërsueshme për të jetuar të lirë në atdheun e tyre. Prandaj, çdo përpjekje për
ta barazuar luftën tonë çlirimtare me krimet e regjimit gjenocidal të Serbisë jo vetëm që e minon
drejtësinë, por dëmton rëndë edhe themelet e paqes afatgjatë në rajonin tonë.

Lufta e UÇK-së ishte shtylla jonë më e fuqishme e rezistencës dhe e shpresës. Kjo e vërtetë
historike është themel i shtetit tonë dhe nuk mund të zhbëhet nga asnjë përpjekje për rishkrim

apo deformim të historisë. Sot, më shumë se kurrë, e kemi për detyrë të qëndrojmë së bashku. Asnjë dallim yni i së kaluarës apo i së tashmes nuk guxon të jetë pengesë në unitetin tonë në mbrojtje të luftës sonë çlirimtare, sepse kështu ne e mbrojmë pastërtinë e lirisë, pavarësisë dhe vetë ekzistencën e shtetit tonë. Sepse, mbi çdo dallim ekziston përgjegjësia jonë e përbashkët për ta mbrojtur këtë shtet, i cili është rezultat i një sakrifice shekullore. Duke e mbrojtur të vërtetën, ne mbrojmë vetë shtetësinë tonë dhe këtë do ta bëjmë për sa të jetë jeta, sepse lufta jonë çlirimtare ishte betimi i përgjakur i një populli, që deshi të jetojë i lirë në tokën e vet.

Secili prej tyre i dha vulën në trup, në shpirt dhe në kujtesë shtetit të cilin e gëzojmë sot. Prandaj sot, detyra jonë është që kjo liri të jetë e denjë për sakrificën e secilit dëshmor dhe secilit martir, që dha jetën për liri.

Kosova u bë shtet për ta mbrojtur të vërtetën dhe për të mos lejuar kurrë që historia të rishkruhet në dëm të atyre që sakrifikuan gjithçka. E populli i Kosovës sakrifikoi gjithçka deri edhe fëmijët në djep, në mënyrë që ne sot ta gëzojmë lirinë. Prandaj, nuk do të pranojmë asnjëherë në Kosovë e kudo në botë, ndonjë narrative që barazon agresorin me viktimën, pushtuesin me të pushtuarin e krimin me rezistencën për liri.

Të nderuar deputetë,

Rruga e Kosovës drejt lirisë ka qenë një rrugëtim i gjatë, i mundimshëm dhe i mbushur me sfida, por edhe me aleanca të fuqishme e me miqësi të sinqerta. Në këtë përvjetor, me mirënjohje të thellë dua t'i falënderoj të gjithë aleatët tanë, aleatë të cilët i ndërtuam me mençurinë dhe vizionin e Presidentit historik, dr. Ibrahim Rugova dhe burra e gra që qëndruan pranë tij në ndërtimin e këtyre aleancave, të cilat do t'i mbrojmë me çdo kusht.

Falënderojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aleatin tonë strategjik! Falënderojmë çdo shtet evropian e gjetiu, gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë, që qëndruan përkrah Kosovës kur liria dukej e largët dhe e pamundur. Pa përkrahjen e tyre politike, diplomatike dhe ushtarake, ëndrra jonë për liri do të ishte akoma e largët.

Sot, pas 18 vjetësh shtetësi, kemi arritur shumë, por kemi akoma shumë rrugë për të bërë përpara. Përgjegjësia jonë e përbashkët është që idealin për të cilin u flijuan dëshmorët ta vazhdojmë ta shndërrojmë në një shtet të fortë, me sovranitet në çdo pëllëmbë të tij, në drejtësi funksionale e të paanshme, në zhvillim ekonomik për çdo qytetar të vendit tonë, në integrim në familjen euroatlantike, aty ku e kemi vendin dhe, mbi të gjitha, në shpresë, shpresë për të rinjtë tanë. 18 vjet shtet janë edhe më shumë përgjegjësi.

Le ta ruajmë Kosovën si amanet. Le ta ndërtojmë të ardhmen me guxim. Le ta mbajmë gjithnjë të gjallë dashurinë për atdheun tonë. Le ta ruajmë lirinë si vlerën më të shtrenjtë dhe ta ndërtojmë shtetin si shtetësi të përbashkët për të gjithë brezat që do të vijnë pas nesh.

Lavdi dëshmorëve të kombit e martirëve të lirisë!
Urime 18-vjetori i Pavarësisë!
Rroftë Republika e Kosovës për mot e jetë!
Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARJA: Faleminderit, e nderuar zonja Presidente!
Në vazhdim ftoj Presidentin e Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj.

PRESIDENTI I SHQIPËRISË, BAJRAM BEGAJ: E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu,
E nderuar kryetare e Kuvendit, zonja Albulena Haxhiu,
I nderuar kryeministër, zoti Kurti,
Të nderuar drejtues të institucioneve kushtetuese,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe deputetë,
Të nderuar përfaqësues të Trupit diplomatik,
Të nderuar përfaqësues të jetës politike, akademike, kulturore, fetare e mediatike, si dhe organizata të dala nga lufta, veteranë dhe familje të dëshmorëve,
E nderuar Familja Rugova,
E nderuar Familja Jashari,
I dashur Baca Rifat,
Vëllezër dhe motra,
Të nderuar miq ndërkombëtarë, të ftuar, pjesëmarrës sot në ceremoni,
Është kënaqësi për mua të jem sot prezent në këtë solemnitet të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Në emër të Republikës së Shqipërisë, ju uroj - gëzuar Ditën e Pavarësisë!

Çdo shqiptar, kudo ndodhet, çdo familje shqiptare në Shqipëri a diasporë, sot ndihet pjesë e festës, e gëzimit, e urimit dhe krenarisë.

Sot është një ditë e madhe. Sot, Kosova mbush 18 vjet. Në jetën e një njeriu, kjo është mosha e pjekurisë, momenti kur ëndrrat e fëmijërisë marrin formën e përgjegjësisë. Në jetën e një shteti, ky përvjetor është dëshmia se Republika e Kosovës është një realitet i pakthyesëm, një shtet sovran. Kosova ishte vendi ku liria vritej, sot është vendi ku liria funksionon, ku liria frymëzon.

Kosova e sotme është një shtet i ri në vite, por me rrënjë të thella sakrificash, kontributesh dhe meritash. Ajo ecën me hapa të sigurt drejt së ardhmes, pa harruar kurrë themelet mbi të cilat u ndërtua. Intelktualët dhe studentët, mendimtarët dhe luftëtarët, u bashkuan rreth idesë së

pavarësisë dhe luftuan me sukses për ideale të mëdha, për lirinë, për të drejtat e tyre, për identitetin kombëtar shqiptar dhe mbijetesën. Nga mençuria dhe vizioni paqësor e largpamës i Presidentit Ibrahim Rugova, që i dha Kosovës miqtë, orientimin euroatlantik dhe besimin në vlera, nga Adem Demaçi, që me sakrificën e tij për liri e bashkim u shndërrua në ndërgjegje kombëtare, te pushka, trimëria dhe heroizmi i Heroit tonë Kombëtar Adem Jashari, dhe lufta e drejtë çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që i dha Kosovës lirinë, ky popull ka treguar se është qëndrestar dhe i pathyeshëm. Kosova ishte me fat që i pati, i rriti, i besoi dhe sot i mban ashtu siç e meritojnë: simbole frymëzuese të Republikës së Kosovës.

Kosova është një histori e jetuar sukcesi, një histori që bën krenar kombin tonë dhe të gjithë ata që luftuan dhe kontribuan gjatë viteve e dekadave, por bën krenar, gjithashtu, edhe miqtë e partnerët tanë strategjikë, sidomos SHBA-në dhe bashkësinë perëndimore. Për herë të parë në histori, NATO përdori nenin e angazhimit duke parandaluar katastrofën humanitare, spastrimin etnik, gjenocidin dhe dëbimin kolektiv të qytetarëve të Kosovës, duke mundësuar rikthimin: rikthimin në shtëpitë e tyre, rikthimin në tokën e tyre, rikthimin në shtetin e tyre, rikthimin në familjen e vlerave evropiane.

Në këtë përvjetor, mendimi ynë shkon tek ata që nuk janë fizikisht mes nesh, zemrat tona janë me dëshmorët e lirisë aty ku ata prehen, por sot mendimi ynë është edhe me ata që po përballen me një betejë të vështirë, të padrejtë dhe vendimtare në Hagë.

Historia e Republikës së Kosovës nuk mund të kuptohet dhe as të shkruhet pa emrat e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe bashkëluftëtarëve të tyre. Ata, që dje udhëhoqën popullin drejt lirisë, sot po përballen padrejtësisht me akuza të montuara në Gjykatën Ndërkombëtare, duke na bërë të gjithëve të ndihemi të fyer, të paragjykuar dhe të akuzuar. Ata, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe të gjithë të tjerët që morën armët për të kërkuar lirinë për atdheun e tyre, lirinë për familjet e tyre, tokën e tyre, gjuhën e tyre, të drejtat e tyre, janë siç kanë qenë e do të jenë gjithmonë kudo, kurdo e në çdo kohë: simbole të lirisë. Ata janë memorie shtetërore e kombëtare.

E vërteta nuk mund të tjetërsohet dhe historia nuk mund të rishkruhet e as ndryshohet, sepse liria ka emër, liria meriton respekt, liria meriton drejtësi, liria meriton mirënjohje.

Republika e Shqipërisë është me UÇK-në, me komandantët dhe ushtarët e UÇK-së, me qytetarët e Kosovës, me dhembjen dhe zemërimin e tyre. Shqipëria ka qëndruar pranë Kosovës, Shqipëria qëndron sot krah Kosovës dhe do të qëndrojë jetë e mot me Kosovën.

Në këtë përvjetor ne kujtojmë se Kosova nuk ishte e vetme në luftën e saj për liri. Mirënjohja jonë e përjetshme shkon për familjen e kombeve perëndimore që u bënë jo vetëm aleatë, por edhe ndërgjegje morale. Mirënjohja jonë e përjetshme shkon për Shtetet e Bashkuara të

Amerikës, NATO-n dhe miqtë ndërkombëtarë, që ndalën gjenocidin ndaj popullit të Kosovës. Sot, Kosova nuk është vetëm produkt i kësaj ndihme, por një nga mbrojtëset më të qëndrueshme të këtyre vlerave.

Të nderuar miq,
Vëllezër e motra,

Kosova e sotme na bën krenarë. Ajo ka konsoliduar institucionet demokratike, ka zhvilluar procese zgjedhore të qeta e gjithëpërfshirëse dhe ka dëshmuar pjekuri demokratike. Vullneti i qytetarëve, i shprehur qartë në zgjedhjet e fundit, tashmë ka marrë formë institucionale me konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë së re. Sfida e tanishme është që ky mandat i besuar nga qytetarët të përkthehet në qeverisje të përgjegjshme, vendimmarrje të guximshme dhe përballim me guxim dhe mençuri të sfidave të dialogut dhe të integritetit evropian.

Urime dhe suksese institucioneve të reja në përmbushjen e përgjegjësisë shtetërore!

Të nderuar të pranishëm,

Bota është në ndryshim. Në pak vite po ndryshojnë dhjetëra vjet politika, pakte, modele dhe projekte. Shqipëria dhe Kosova janë të orientuara drejt e pa ekuivok. Kjo nuk është zgjedhja jonë kalimtare, nuk është zgjedhje e rastësishme, është zgjedhja jonë strategjike, afatgjatë dhe pjesë e identitetit tonë kombëtar.

Marrëdhënia mes Shqipërisë dhe Kosovës është organike, vëllazërore dhe e shenjtë. Ne jemi një komb që rreh në dy shtete. Shqipëria është shtëpia juaj, ashtu si Kosova është shpirti ynë.

Bashkëpunimi ynë në çdo fushë nuk është zgjedhje politike dhe as interes i përkohshëm, është detyrimi ynë ndaj brezave.

Shqipëria dhe Kosova, krah për krah, ecin sot me të njëjtën busull drejt një hapësire ku vlerat e lirisë, demokracisë dhe paqes janë të pacenueshme. Ky 18-vjetor na rikujton se, ashtu siç ishim bashkë në ditët e vështira të mbijetesës, do të jemi bashkë edhe në tryezat e Brukselit, për të dëshmuar se shpirti i shqiptarit ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë e përjetësisht euroatlantik. Shqiptarët në rajon, si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi kanë qenë dhe mbeten një faktor i rëndësishëm emancipues, integruues dhe evropianizues, si dhe kontribuues për paqen, sigurinë, stabilitetin dhe begatinë në rajonin tonë, por edhe më gjerë.

Nuk mund të ketë Evropë të plotë pa një Kosovë të barabartë mes të barabartëve. Shqipëria do të vazhdojë të jetë një zë i Kosovës në çdo tryezë ndërkombëtare, derisa flamuri i saj të valëvitet në Organizatat e Kombeve të Bashkuara dhe në NATO.

Republika e Kosovës e meriton statusin e vendit kandidat në Bashkimin Evropian dhe heqjen e çdo mase kufizuese. Një Kosovë e integruar dhe një faktor shqiptar i fuqizuar janë garanci për stabilitet, demokraci dhe fqinjësi të mirë.

Pas 18 vjetësh, Kosova nuk është më një projekt shprese. Është një shtet real, me sfida reale dhe me potencial të jashtëzakonshëm. Kosova sot është më e fortë se dje dhe më e përgatitur për sfidat e së nesërme. Sfidat mbeten, por edhe vendosmëria jonë për t'i përballuar ato është e palëkundur.

E ardhmja e Republikës së Kosovës është evropiane, demokratike dhe e lidhur ngushtë me Republikën e Shqipërisë.

Të dashur vëllezër e motra,

Me këto mesazhe vëllazërore unë dëshiroj të konfirmoj edhe një herë se është i përbashkët për çdo kryetar shteti të Shqipërisë, qeveri apo parti politike, institucion apo qytetar shqiptar urimi që Kosova të ketë progres, të ketë progres demokratik e mirëqenie për qytetarët e saj, të ketë sukses dhe zhvillim, të forcojë paqen, të avancojë dialogun politik dhe të mbetet jo vetëm shteti me moshën më të re të popullsisë, por edhe shteti që ndërton një të ardhme evropiane për rininë, me rininë dhe në pritshmëritë e të rinjve.

Gëzojeni këtë liri të fituar me gjak dhe të mbajtur me mund dhe sakrifica!

Lavdi dëshmorëve të kombit! Lavdi përjetë Pavarësia!

Bekuar qoftë Republika e Kosovës!

Rroftë kombi shqiptar!

Rrofshin miqtë e shqiptarëve!

(Duartrokitje)

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar president Begaj!

Më lejoni që me rastin e kremtimit të 18-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, t'ju drejtohem me një fjalë rasti.

E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osman-Sadriu!

I nderuar President i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj,

Të nderuar deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

I nderuari Baci Rifat Jashari,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Drejtues e përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës,

Shkëlqesi ambasadorë dhe miq ndërkombëtarë,

Të dashur qytetarë,

Media që po e përcillni këtë seancë solemne,

Sot shënojmë 17 Shkurtin - Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, pavarësinë që u bë e mundur falë përpjekjeve dhe sakrificave të vazhdueshme të popullit shqiptar, pavarësisë që u arrit përmes luftës për çlirim, gjakut të shumë heronjve që ranë dëshmorë ndër breza që ne të jemi sot ku jemi këtu.

Përkulje e përhershme ndaj atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit, para dëshmorëve dhe martirëve, para atyre që përjetuan dhunë në forma të ndryshme, para familjeve që ende mbajnë dhimbjen e luftës dhe të gjithë atyre që edhe sot kërkojnë drejtësi. Përkulje para të gjithë atyre që qëndruan dhe nuk u dorëzuan asnjëherë, që ne sot të jetojmë të lirë në tokën që e kemi trashëguar në shtetin tonë të lirë.

Në këtë ditë, kujtojmë dhe ndihemi krenarë për heroizmin e familjes së Komandantit legjendar Adem Jashari dhe gjithë Jasharëve që u bënë simbol i rezistencës tonë të fuqishme kundër okupimit. Kujtojmë dhe nderojmë urtësinë e presidentit Rugova që e orientoi Kosovën drejt mbështetjes ndërkombëtare. Kujtojmë qëndresën e pathyeshme të Bacës Adem, Adem Demaçit, udhërrëfyesit tonë që mbetet shembull i sakrificës së popullit tonë në rrugën e tij për liri dhe dinjitet. Këto tri linja të historisë sonë çlirimtare e fitimtare u ngritën mbi lavdinë e historisë së qëndresës shekullore ndaj okupimit.

Veprimtare dhe veprimtarë, aktiviste dhe aktivistë, studente e studentë dhe punëtore e punëtorë që brenda dhe jashtë vendit në diasporë u angazhuan për një Kosovë të lirë.

Falënderim i veçantë miqve dhe aleatëve ndërkombëtarë që na mbështetën në rrugën për pavarësi dhe vazhdojnë të qëndrojnë pranë Kosovës në ndërtimin e saj.

Të nderuar të pranishëm,

Këtë ditë të rëndësishme e lartëson ajo që qëndron në themelin e Republikës sonë, ajo që buroi nga populli, që është sa mundësia edhe e vërteta e tij, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta e saj e drejtë për çlirim. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë për dinjitet dhe liri. Ajo ishte kundërpërgjigje në rrethanat e një okupimi të ashpër, kur dhuna sistematike ndaj popullit shqiptar po merrte përmasa shkatërruese. UÇK-ja ishte ushtria mbrojtëse e një populli që kërkonte të jetonte i lirë në vendin e vet, pa pasur synim shkatërrimin e askujt tjetër dhe çdo përpjekje për ta shkëputur këtë luftë nga konteksti i saj historik dhe politik rrezikon ta shtrembërojë të vërtetën e asaj kohe. Aq shumë kishte besim në drejtësinë e luftës sonë sa që bota demokratike aso kohe intervenoi e më vonë edhe e mbështeti pavarësinë e vendit tonë.

Ne i kujtojmë këto të vërteta, sepse populli i Kosovës e përjeton si të padrejtë Gjykatën Speciale dhe këtë gjykim së pari, sepse anashkalon vetë rrethanat në të cilat u zhvillua lufta jonë çlirimtare. Lufta jonë nuk ishte agresion, por rezistencë ndaj okupimit dhe shtypjes, ndaj gjenocidit dhe spastrimit etnik. Luftë për të mbrojtur tokën tonë, pragun e shtëpisë, familjet, qytetarët civilë të paarmatosur në Kosovë.

Institucionet e Republikës së Kosovës do të vazhdojnë ta mbrojnë të vërtetën historike, vlerën dhe dinjitetin e luftës për liri dhe parimet themelore të drejtësisë, duke kundërshtuar çdo përpjekje për ta deformuar atë.

Të nderuar të pranishëm,

Kosova sot është një shtet 18-vjeçar, si një e re apo e ri që është rritur, forcuar dhe po ecën përpara me besim e ambicie të shtuara për vete. Kemi një ekonomi më të zhvilluar, stabilitet institucional, siguri dhe mbështetje të qytetarëve tanë pa lënë mbrapa askënd. Shteti ynë po konsolidohet dhe po e rrit rolin e tij brenda, por edhe jashtë vendit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës do të vazhdojë të mbështesë proceset reformuese dhe ato që kanë për synim zhvillimin e vendit. 18 vjet pas shpalljes, mënyra më e mirë për ta jetësuar pavarësinë është duke e nderuar Republikën, e kjo arrihet vetëm përmes institucioneve që funksionojnë me integritet dhe me profesionalizëm dhe që janë në shërbim të qytetarëve tanë.

Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve, i ndërtuar mbi parimin e barazisë dhe respektin. Ajo është pjesë e botës demokratike dhe e përkushtuar për integrim dhe bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Të dashur qytetarë,

Republika jonë u ndërtua me sakrificë dhe mbahet gjallë me përkushtim të përditshëm. Detyra jonë është që ta ruajmë, ta forcojmë dhe ta zhvillojmë, që brezat që vijnë të jetojnë në një vend edhe më të drejtë, edhe më të sigurt, edhe më të begatë.

Urime 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Lavdi dëshmorëve dhe martirëve të lirisë!
Faleminderit!

(Duartrokitje)

Tani e ftojme kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, për fjalën e tij.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Shkëlqesia juaj, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, presidente e Republikës së Kosovës,
Shkëlqesia juaj, z. Bajram Begaj, president i Republikës së Shqipërisë,
E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Albulena Haxhiu,
I nderuar Baca Rifat,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Legjislaturës X,
Zëvendëskryeministër dhe ministra të qeverisë,
Të nderuar ambasadorë dhe miq të tjerë ndërkombëtarë,
Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të UÇK-së,
Drejtues e përfaqësues të institucioneve të shtetit,
Klerikë fetarë,
Të dashur qytetarë të Republikës,
Të nderuar të pranishëm,
Zonja dhe zotërinj,
18 vjet më parë, data e sotme iu shtua kalendarit tonë kombëtar, krahas 2 Marsit të Kuvendit të Lezhës, 5, 6 e 7 Marsit të Betejës heroike të Familjes Jashari, 11 Marsit të demonstratave të studentëve, 10 Qershorit të Lidhjes së Prizrenit, 12 Qershorit të çlirimit të Kosovës, 2 Korrikut të Deklaratës kushtetuese, 7 Shtatorit të Kushtetutës së Kaçanikut, 22 Nëntorit të Kongresit të Alfabetit dhe 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit. Kjo, sepse më 17 Shkurt, me shpalljen e pavarësisë së Republikës sonë, u arrit një shkallë tjetër e lartë në përfaqësimin tonë në Ballkan dhe në Evropë.

Dita e sotme është ditë përkujtimi për të gjithë ata burra, gra e fëmijë që flijuan shumëçka e gjithçka për Republikën e Kosovës. Aktivistët e luftëtarët që u përpoqën për jetësimin e republikës, së paku që nga viti 1968 e këtej, ndoshta nuk kanë pasur të gjithë të njëjtën përfytyrim e vizion se si do të ishte Republika, por ata kishin të njëjtën dëshirë për liri. Republika, në radhë të parë është institucion i lirisë, shprehje e sovranitetit, mjet për zhvillim. Prandaj, kur vjen fjala te Republika dhe sovraniteti, ne nuk mund të lëshojmë pe, sepse nuk bëjmë dot kompromis me lirinë dhe me zhvillimin. Ne i kujtojmë përfytyrimet dhe vizionet e perealizuara të aktivistëve dhe të luftëtarëve që e kanë dëshiruar Republikën, sepse pa sakrificën e tyre nuk do të kishim shtetin tonë dhe mu ato na frymëzojnë e na orientojnë për ta forcuar edhe më shumë atë.

Ne kujtojmë sot qëndresën paqësore të viteve 1990, dhe ne kujtojmë sot Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ne përulemi me nderim para dëshmorëve dhe përpiqemi që ta ruajmë dhe ta lartësojmë Republikën tonë, edhe në emrin e tyre. Ndërsa kujtojmë datën e shpalljes së Republikës, brengosemi që krerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e të Republikës së Kosovës, po akuzohen padrejtësisht, sepse ata guxuan të marrin armët për liri, kundër shtypjes njëshekullore dhe kundër një regjimi gjenocidal. Akuzat e Prokurorisë Speciale në Hagë për krime kundër njerëzimit nuk qëndrojnë. Ato nuk marrin parasysh kontekstin historik e politik të luftës sonë çlirimtare, së cilës

ia detyrojmë lirinë e sotme. Krime kundër njerëzimit ndaj popullatës civile shqiptare ka kryer Serbia e Milosheviqit. Kërcënim për përsëritjen e tyre është sot Serbia e Vuçiqit. Barazimi mes krerëve të UÇK-së dhe një regjimi gjenocidal është i paqëndrueshëm dhe i papranueshëm për ne.

Të nderuar të pranishëm,

Republika nuk lëshon pe kur është çështja e sovranitetit shtetëror, integritetit territorial dhe demokracisë popullore. Demokracia është edhe, burim edhe shprehje e sovranitetit të Kosovës, ku përveç shqiptarëve, Kushtetuta jonë njeh serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalitë, egjiptianët, goranët. Të gjithë janë pjesë e popullit të Kosovës dhe marrin pjesë në zgjedhjet demokratike, në institucione zyrtare dhe në jetesën e përbashkët, duke respektuar ligjin dhe të drejtat e njëri-tjetrit. Zgjedhjet e fundit demokratike, pas një ngërçi disamujor në Kuvend, treguan edhe një herë vlerën e demokracisë, të zgjedhjeve të lira e të ndershme. Republika nuk detyrohet së jashtmi, me imponim e dhunë, por ndërtohet së brendshmi me punën tonë të përbashkët.

Qeveria e re do të vazhdojë angazhimin për zhvillimin ekonomik, për fuqizimin e sigurisë dhe për thellimin e arsimit e të kulturës. Ekonomi do të thotë prodhim e mirëqenie shoqërore, siguri do të thotë mbrojtje e rend publik, arsim e kulturë do të thotë inteligjencë e kapital njerëzor. Për ta thënë me një formulë: ne do të mbrojmë prodhimin inteligjent. Kështu do të konsolidojmë rritjen ekonomike dhe do të jemi më konkurrues në rajon e më gjerë, e kjo doemos e shoqëruar me rritjen e mirëqenies shoqërore dhe me rritjen e kapaciteteve mbrojtëse të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pas liberalizimit të vizave me Zonën Schengen, tani pasaporta e shtetit tonë është më e fortë se kurrë më parë. Po renditemi gjithnjë e më lart në listimin ndërkombëtar, për sa u përket sigurisë, demokracisë, të drejtave e lirive, sundimit të ligjit, mirëqenies, klimës për investime të huaja direkte etj.

Të nderuar pjesëmarrës,

Kur u miratua Plani i Ahtisaarit, në bazë të të cilit u shpall pavarësia e Kosovës, bota kishte tjetër pamje dhe kufizimet që na viheshin për të drejtën tonë për vetëvendosje mendohej se do të kompensoheshin sa me transformimin evropian të Serbisë, aq edhe me përfshirjen e shtetit tonë në sistemin kolektiv euro-atlantik. Mirëpo sot ne shohim se pasiguria në botë është rritur dhe se bllokut perëndimor i nevojitet koherenca e brendshme për ta mbajtur sistemin e sigurisë në Evropë dhe për ta udhëhequr botën drejt vlerave të lirisë, të demokracisë, të solidaritetit, të barazisë dhe sidomos të të drejtave të njeriut. Ndryshimet në mjedisin ndërkombëtar janë të pashmangshme dhe ndonjëherë të paparashikueshme. Në anën tjetër, fqinji ynë verior, Serbia, i do veçse eurot nga Evropa, porse orientimin e ka te Kremlin. Prandaj, nevojitet që të forcojmë edhe më tej shtetësinë e Kosovës, demokracinë dhe aleancat me shtetet perëndimore dhe me ato shtete fqinje që kanë të njëjtat vlera e interesa sikurse ne. Për fat të mirë, në Konferencën e Sigurisë në Mynih para pak ditësh, ku mora pjesë si përfaqësues i Kosovës, Shtetet e Bashkuara

të Amerikës dhe shtetet evropiane konfirmuan se vlerat euroatlantike mbeten të njëjta, po ato vlera që ne i kemi të shkruara në Kushtetutën tonë.

Ne jemi të vendosur të vijojmë rrugën tonë të integrimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian, si dhe të anëtarësimit në Këshillin e Evropës. Ne jemi të gatshëm që të japim kontributin që na takon për fuqizimin dhe reformimin e sigurisë kolektive në rajonin tonë dhe në Evropë, siç kemi bërë dhe më parë. Për këtë do të vijojmë të mbështetemi te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, te Gjermania, te Britania e Madhe, te Turqia, Franca e Italia, Kanadaja e Japonia, sikurse që do të kultivojmë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin edhe me shtete të tjera. Do të bashkëpunojmë edhe me shtetet evropiane që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës si shtet të pavarur, sikurse do të përpiqemi që t'i sigurojmë Kosovës njohje të reja anembanë botës, në mënyrë që të anëtarësohemi në organizata ndërkombëtare, siç na takon si shtet sovran e demokratik që jemi.

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbetet kyç bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë, si dhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe me Republikën e Malit të Zi, shtete ku jetojnë pjesë të kombit shqiptar. Aleanca e mbrojtjes me Shqipërinë dhe Kroacinë është një element më shumë në sigurinë dhe paqen rajonale demokratike, përballë faktorëve destabilizues.

Në këtë ditë të shpalljes së pavarësisë, qytetarët tanë gëzojnë më shumë mbrojtje, demokraci e begati. Kosova nuk është vetëm një shtet i ri në hartën e Evropës, por është një partner i besueshëm i vendeve demokratike. Rruga jonë mbetet e njëjtë, sepse atë e kanë përcaktuar historia e kombit shqiptar, historia e afërt e lëvizjeve paqësore, lufta çlirimtare, proceset demokratizuese në Evropë dhe vullneti i popullit të Kosovës për liri e mirëqenie. Sakrifica e njerëzve tanë për liri ka qenë e përkryer. Puna jonë për Republikën duhet të jetë po aq e përkryer. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar kryeministër për fjalën! Tani është radha e grupeve parlamentare. Ftoj përfaqësuesen e Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu!

I nderuar president i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj,

E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Albulena Haxhiu,

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,

Të nderuar deputetë,

I dashur Baca Rifat,

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar familjarë të familjeve Jashari, Rugova, familjarë të familjeve të dëshmorëve,

Përfaqësues të institucioneve,

Përfaqësues të vendeve mike që jeni bashkë me ne në shënimin e kësaj dite.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jemi mbledhur sot në këtë se anë solemne për të shënuar një nga ditët më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, 18-vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Si sot 18 vjet më parë, më 17 shkurt 2008, Kosova e shpalli vullnetin e saj të lirë për të qenë shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Ishte një akt historik që kurorëzoi sakrificën shekullore të popullit tonë për liri, dinjitet dhe vetëvendosje.

Kjo ditë është një kujtesë e gjallë e rrugëtimit tonë të vështirë, e qëndresës së brezave të tërë, e luftës së pastër e të drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e gjakut të derdhur për lirinë që sot e gëzojmë. Është dita që na kujton sakrificën e Familjes Jashari. Është dita që na ndërmend dëshmorët dhe martirët, të mbijetuarit e dhunës seksuale. 1133 fëmijët e vrarë. Është dita që e shënojmë me vetëdijen se shumë familje vazhdojnë akoma të vuajnë e t'u mungojnë më të dashurit e tyre, të zhdukurit me dhunë.

Prandaj, sot e çdo ditë me nderimin më të thellë përkulemi para dëshmorëve të kombit, martirëve dhe të gjithë atyre që kontribuan për çlirimin dhe ndërtimin e shtetit tonë.

Dhembja është e madhe, por edhe krenaria për ata që dhanë gjithçka për vendin. Do të mbeten përjetësisht udhërrëfyesit e rrugëtimit tonë.

Një falënderim i veçantë për shtetet mike dhe partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e vazhdueshme në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe konsolidimit shtetëror.

Të nderuar të pranishëm,

Sot, Kosova është një realitet shtetëror i pakthyesëm. Një shtet që pavarësisht sfidave ka dëshmuar forcë, stabilitet dhe përkushtim ndaj vlerave demokratike. Një shtet që po ndërton institucione, po fuqizon sundimin e ligjit dhe po ecën me vendosmëri drejt integriteteve euroatlantike.

Shpallja e pavarësisë ishte fillimi i një përgjegjësie për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët tanë pa dallim. Përgjegjësi për t'u ofruar me përkushtim të rinjve tanë perspektivë, shpresë dhe arsye për të ndërtuar të ardhmen e tyre këtu në vendin tonë.

Në këtë përvjetor, ne riafirmojmë angazhimin tonë si përfaqësues të popullit për të forcuar shtetin, për ta mbrojtur kushtetutshmërinë dhe për ta avancuar interesin qytetar mbi çdo interes tjetër.

Kosova ka dëshmuar se di të qëndrojë e fortë edhe në kohët më të vështira. Me unitet, punë dhe vizion të qartë, ne do ta çojmë përpara ëndrrën e atyre që sakrifikuan gjithçka për këtë ditë. Shteti ynë është i ri, por jo i brishtë. Kosova po forcohet çdo ditë e më shumë si brenda vendit, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Është përgjegjësi e të gjithë neve që të investojmë dhe të japim më të mirën për të ardhmen e brezave që do të vijnë, pa u kursye.

Lavdi dëshmorëve dhe martirëve të kombit!

Urime Dita e Pavarësisë! E paçim përjetë të zhvilluar e të begatë Kosovën tonë! Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci! Tani nga Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, zonja Osmani-Sadriu,

I nderuar president i Republikës së Shqipërisë, zoti Begaj,

E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, zonja Haxhiu,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zoti Albin Kurti,

Të nderuar ministra,

E nderuara familje Jashari,

E nderuar familje Rugova,

I dashur Baca Rifat,

Të nderuar familje të dëshmorëve,

Veteranë,

Kor diplomatik,

Deputetë të Parlamentit britanik,

Prijës fetarë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Zonja dhe zotërinj,

Më 17 Shkurt 2008, në orën 15:39, është dita dhe ora kur flamuri ynë u ngrit për herë të parë në këto institucione.

Është dita kur guximi i brezave të tërë dhe sakrifica e tyre u bë shpresë e përhershme për çdo qytetar, u shpall Republika e Kosovës. U shpall fundi i një padrejtësie historike. Kjo ditë nuk ishte rastësi. Ishte përfundim i një rrugë të gjatë dhe sakrifice. Ishte kulmi i rezistencës. Ishte fitore e vendosmërisë së një populli që refuzoi të nënshtrohej. Kosova kaloi nga sakrifica në sovranitet, nga rezistenca në Republikë dhe nga ëndrra shekullore, në realitet shtetëror. Pra, kjo Republikë është fitore.

Themelet e saj janë të skalitura me gjakun e dëshmorëve, janë të ngritura mbi sakrificën e atyre që zgjodhën lirinë mbi jetën. Prandaj, sot në këtë ditë shumë të rëndësishme për popullin tonë, ne përulemi me mirënjohje para familjeve të dëshmorëve, para luftëtarëve të lirisë, para çdo qytetari që kontribuoi për këtë ditë, dhe përulemi me mirënjohje edhe para aleatëve tonë.

Në orët më të errëta të historisë sonë, bota demokratike nuk heshti. Ndërhyrja e NATO-s ishte momenti kur ndërgjegjja e qytetërimit u bë mburojë e Kosovës. U jemi përjetësisht mirënjohës Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mikut tonë të madh dhe aleatit tonë strategjik që qëndruan në anën e duhur të historisë.

Faleminderit vendeve të Bashkimit Evropian dhe çdo shteti që njohu pavarësinë tonë! Faleminderit ushtarëve të KFOR-it që garantuan paqen dhe sigurinë në tokën tonë! Kosova nuk harron. Kosova di t'i nderojë miqtë dhe Kosova mbetet e palëkundur në aleancat e saj euroatlantike, sepse liria jonë është meritë edhe e miqve tanë.

Të nderuar të pranishëm,

Shtetësia nuk është vetëm flamur dhe himn, është siguri dhe drejtësi. Është ruajtje e së vërtetës sonë historike. Sot festojmë, por njëkohësisht edhe reflektojmë, sepse ndërkohë që ne ndërtojmë të ardhmen, pjesa më e lavdishme e historisë sonë, lufta çlirimtare është në bankën e të akuzuarve në Hagë. Lufta jonë çlirimtare po gjykohet. Ata kanë kontribut në shtet. Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi po gjykohen.

Dhe, sot duhet ta themi qartë dhe me vendosmëri, besimi i Kosovës në drejtësinë ndërkombëtare nuk duhet tradhtuar. Ne nuk lejojmë që historia të rishkruhet në kurriz të sakrificës sonë. Ne nuk pranojmë barazi artificiale mes agresorit shtetëror serb dhe rezistencës sonë për liri. Ne nuk pranojmë që drejtësia të bëhet selektive. UÇK-ja nuk ishte ndërmarrje kriminale, ishte ushtri çlirimtare, ishte përgjigje ndaj shtypjes, ishte zëri i një popullit që nuk kishte më rrugë tjetër.

Kosova kërkon drejtësi, por drejtësi të vërtetë. Drejtësi që nuk relativizon sakrificën, drejtësi që nuk i nënshtrohet politikës, sepse liria jonë nuk është krim. Pavarësia jonë nuk është gabim historik. Ajo është e drejtë e fituar me shumë heronj, dëshmorë, martirë dhe me përkrahjen e aleatëve tonë.

Të nderuar të pranishëm,

Kosova është realitet i pakthyeshëm. Shteti ynë është projekt i përfunduar i lirisë. Sfida kemi, beteja kemi, por ne do të triumfojmë. Shtetin tonë do ta bëjmë më të fortë, institucione më efikase, drejtësinë më të barabartë, demokracinë më funksionale, por mbi të gjitha, do ta ruajmë kujtesën tonë, sepse një popull që harron sakrificën, rrezikon ta humbasë lirinë dhe ne nuk do ta humbasim.

Kosova është shtëpia jonë, është amaneti ynë, është përgjegjësia jonë. Liria jonë ka emra, ka varre, ka histori që nuk shlyhen, dhe mbi këto sakrifica qëndron Republika jonë e lirë, sovrane dhe e përjetshme.

Gëzuar Ditën e Pavarësisë! Gëzuar Ditën e shtetësisë së Kosovës. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KYRETARJA: Faleminderit, zoti Hamza! Tani është radha e Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu,

I nderuar president i Republikës së Shqipërisë, zoti Bajram Begaj,

Baca Rifat,

I nderuar kryeministër Kurti,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Korit Diplomatik,

Ushtarakë e oficerë të Forcës së Kosovës,

Familjarë të dëshmorëve,

Veteranë të luftës çlirimtare,

Përfaqësues të institucioneve vendore,

Qytetarë të nderuar të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka ditë kur historia na fton të flasim, e ka ditë kur na kërkon të dëgjojmë. Gjithsesi, ka ditë si kjo e sotmja kur na kërkon të kujtojmë me dinjitet dhe të flasim me plot përgjegjësi. 18 vjet më parë Kosova u bë shtet, por shumë më herët Kosova kishte vendosur të jetë e lirë e të bëhej shtet.

Dhe, sot, teksa qëndrojmë në këtë tempull të shenjtë të pavarësisë, të trimëruar edhe nga shpirti i të parëve tanë dhe vullneti i paepur i popullit tonë për liri e shtetësi, ne duhet t'ia kujtojmë vetes se pavarësia e Republikës sonë nuk ishte vetëm një akt dite, pavarësia jonë është kulmi i një procesi të gjatë shekullor për mbijetesë, për identitet dhe, mbi të gjitha, për dinjitet. Është rezultat i një përpjekjeje kolektive që kalon përmes epokave, përmes sakrificave individuale dhe qëndrueshmërisë shoqërore, pra përmes mendimit politik dhe, mbi të gjitha, qëndresës morale.

Prandaj, në këtë ditë ne nuk e kujtojmë vetëm aktin e 17 Shkurtit 2008. Ne e kujtojmë gjithë rrugën që na solli deri aty. Kujtojmë vitet e mohimit, vitet e rezistencës, vitet e durimit dhe vitet e sakrificës. Kujtojmë një popull që zgjodhi të mos zhdukej dhe të mos dorëzohej edhe kur gjithçka dukej e pamundur.

Në themel të kësaj rruge qëndron filozofia politike e atit themeltar të Republikës sonë, presidentit historik Doktor Ibrahim Rugova dhe gjithë lëvizjes paqësore të viteve '90. Rugova dhe Lëvizja e madhe për liri, për pavarësi e demokraci i dha Kosovës një orientim historik epokal. E ktheu çështjen e saj nga një konflikt i harruar në Jugosllavi në një çështje ndërkombëtare, nga një realitet i dhunshëm në një projekt politik me legjitimitet moral.

Ai e konceptoi lirinë si vlerë universale dhe shtetin si projekt kulturor e projekt demokratik. Lëvizja paqësore nuk ishte zgjedhje e lehtë, ishte zgjedhje e vetëdijshme dhe e guximshme. Ishte bindja se një popull i vogël, por me të drejtë të madhe, të jashtëzakonshme, duhej ta fitonte përkrahjen e botës perëndimore përmes maturisë, qëndrueshmërisë dhe vizionit. Ishte refuzim i urrejtjes dhe hakmarrjes si mjete politike. Ishte zgjedhje për ta ruajtur shoqërinë, për ta mbajtur gjallë kombin dhe për ta ndërtuar shtetin mbi vlara.

Rugova i mësoi Kosovës se durimi nuk është dorëzim, por është forcë e përmbajtur, se paqja nuk është mungesë guximi, por strategji e mençurisë dhe se orientimi euroatlantik nuk është zgjedhje e momentit, por identitet politik i përhershëm i popullit të Kosovës. Ai e pa shtetin, jo si instrument pushteti, por si kornizë morale, ku qytetari ndihet i mbrojtur dhe respektuar. Por, historia jonë është e paplotë nëse nuk është e vërtetë dhe e vërteta e Kosovës është se krahas së rezistencës paqësore erdhi edhe momenti kur dhuna shtetërore e Serbisë dhe mohimi total i të drejtave të një vendi që kërkonte liri e sollën popullin tonë përballë nevojës për mbrojtje të armatosur.

Familja Jashari dhe Prekazi janë kthesë historike e kësaj rruge. Sakrifika e tyre e përmasave që vështirë mund të shpjegohen e fliten edhe me një fjalim si ky imi nuk ishte vetëm heroizëm individual, ishte akt themelues i ndërgjegjes sonë kolektive, akt themelues i vetë çlirimit. Ishte dëshmi se liria ka çmim dhe se ndonjëherë ai çmim paguhet me më të shtrenjtën, me jetën. Prekazi e zgjoi ndërgjegjen kombëtare dhe atë ndërkombëtare dhe bëri të qartë se padrejtësia kishte arritur kufirin e saj të fundit.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte përgjigje e një populli të shtypur ndaj dhunës sistematike dhe krimeve kundër njerëzimit. UÇK-ja u bë faktor i pashmangshëm i realitetit politik dhe historik, duke u ndërthurur me përpjekjet diplomatike dhe me mbështetjen vendimtare të aleatëve tanë ndërkombëtarë. Sakrifika e luftëtarëve të UÇK-së, e heronjve, e dëshmorëve, e martirëve, që na qëndrojnë në altarin e kësaj republike, mbetet pjesë e pandashme e historisë sonë të lirisë. Dhe, më lejoni të them këtu, se nuk ka gjë, nuk ka as proces, nuk ka as forcë që e ndryshon lavdinë e kësaj lufte të pastër dhe historike të popullit të Kosovës dhe Ushtrisë sonë Çlirimtare. UÇK është vetë populli i Kosovës.

Këto dy rrugë, ajo paqësore dhe ajo çlirimtare, janë rrugët e popullit tonë drejt lirisë dhe pavarësisë. Ato nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Ato e plotësojnë njëra-tjetrën. Ato së bashku

krijuan kushte që Kosova të mbijetojë, të çlirohet dhe, më në fund, të bëhet shtet. Vetëm duke i respektuar të dyja, historia jonë mbetet e plotë dhe e ndershme.

Prandaj, populli i Kosovës sot e nëpër brezni do ta respektojë Lëvizjen paqësore dhe luftën çlirimtare si vlera identitare të shtetit tonë. Dhe, në këtë ditë feste nderojmë në veçanti dhe viktimat civile të luftës, gratë, fëmijët, të moshuarit, të vrarë e të zhdukur, vetëm sepse ishin shqiptarë dhe sepse deshën të jetonin të lirë në atdheun e tyre. Ata janë pjesë e përhershme e ndërgjegjes sonë kombëtare dhe kujtimi i tyre nuk është vetëm dhimbje e tanishme, është përgjegjësi shtetërore. Përgjegjësi për t'i nderuar me të vërtetën, për t'i mbrojtur nga harresa dhe për të kërkuar drejtësi në emrin e tyre.

Në këtë ditë feste e gëzimi të 17 Shkurtit dhe jo vetëm, ndiejmë detyrimin tonë për mirënjohje e falënderime të përjetshme ndaj aleatëve tanë nga e gjithë bota. Në veçanti, mirënjohje të veçantë të gjitha shteteve të Aleancës Veriatlantike të NATO-s, Bashkimit Evropian, Mbretërisë së Bashkuar, e në veçanti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që në orët tona më të vështira u gjendën në krah tonin.

Shtëpia nuk mbahet pa miq, nuk mbahej dje, s'mbahet sot, s'do të mbahet as edhe nesër.

Në këtë ditë të veçantë le të nderojmë dhe vetë ditën e 17 Shkurtit si ngjarje kulmore e historisë sonë për shtetësi. Shpallja e pavarësisë ishte akt i unitetit kombëtar dhe politik. Ishte dëshmi se Kosova dinte të bashkohej kur historia e kërkonte.

Presidenti i Republikës Fatmir Sejdiu, kryeministri Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, dhe të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës të asaj legjislature e kishin jo vetëm fatin historik, por dhe peshën e madhe të një rrugëtimi gjeneracional që ta shpallin pavarësinë e Kosovës dhe pa dallim politik e shpallën Kosovën shtet të pavarur dhe sovran në një nga momentet më të ndritura të historisë sonë moderne.

Ajo e diel e 17 Shkurtit nuk ishte ditë e një force politike, ishte ditë e shtetit, ishte ditë e qytetarëve, ishte ditë e unitetit dhe që atëherë dita e 17 Shkurtit duhet të festohet si e tillë.

Sot, 18 vjet më pas, kemi shumë arsye të jemi krenarë. Krenarë për shtetin që e kemi. Krenarë për institucionet që i kemi. Krenarë për fatin se Kosova qëndron si shtet i lirë, demokratik dhe i orientuar qartë drejt botës euroatlantike. Krenarë për flamurin tonë, për kushtetutën tonë dhe për qytetarët tanë të të gjitha etnive. Kemi arsye të jemi krenarë për mënyrën se si Kosova u njoh nga shtetet demokratike të botës, për mënyrën se si u integruam në mekanizma ndërkombëtarë, për mënyrën se si e ruajtëm paqen, stabilitetin dhe orientimin tonë perëndimor edhe në kohë shumë të vështira.

Por, festa vërtetë e pavarësisë nuk mbaron me krenari për të kaluarën, ajo vazhdon me përgjegjësinë për të tashmen dhe detyrimin që kemi ndaj së ardhmes. Sepse pavarësia nuk është vetëm trashëgimi që e gëzojmë, është amanet që duhet ta ruajmë dhe ta forcojmë secilën ditë.

Sot, si përfaqësues politikë që jemi, si institucione, si qytetarë, kemi një përgjegjësi të madhe historike. Përgjegjësinë që shtetin e fituar me sakrificë ta bëjmë shtet funksional. Që lirinë e fituar me gjak ta mbrojmë me ligj të vërtetë. Që demokracinë e ndërtuar me durim ta zhvillojmë me punë të pandalshme. Gjendja në të cilën ndodhet sot Kosova na obligon. Na obligon si patriotë që duhet të jemi, na obligon të mos mjaftohemi me simbolikë, por të kërkojmë përmbajtje. Na obligon të mos e relativizojmë shtetin, por ta forcojmë atë, sepse shteti nuk dobësohet vetëm nga armiq të jashtëm, por edhe nga papërgjegjësia e brendshme.

Përgjegjësia jonë sot është që Kosova të mos e humbë as besimin e qytetarëve të saj, që të rinjtë tanë të mos e shohin largimin si zgjidhje, që puna të shpërblehet, ligji të vlejë njësoj për të gjithë dhe institucionet të jenë në shërbim të qytetarëve, ashtu siç e na mësuam themeluesit e shtetit tonë.

Zonja dhe zotërinj,

Në 18-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, të kësaj ngjarjeje madhore historike, në frymën e festës dhe gëzimit, më lejoni që në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës t'ju uroj të gjithëve për këtë ditë të shënuar. Le të shërbejë kjo ditë e kjo datë si frymëzim, e si nxitje pozitive që të punojë më shumë e me vullnet më të mirë për vendin tonë, për atdheun tonë, për Republikën tonë. Që të zotërojnë paqja, liria dhe demokracia, vlera ideale këto për të cilat u angazhuam me dekada të palëkundur përkundër shtypjes, terrorit, dhunës e luftës.

Është detyra jona që këto vlera t'i ruajmë, por edhe t'ua përcjellim breznive që vijnë, sepse kështu e bëjmë vendin tonë një çerdhe të ëndrrave e vlerave tona të përbashkëta. E shkuara jonë është e lavdishme, paqësore dhe çlirimtare dhe është e papërsëritshme, mbi të gjitha është e paarritshme dhe e pandryshueshme.

E ardhmja jonë është e padeфинuar, është e pashkruar dhe aty sot kemi rol ne. Aty ne duhet t'i përcaktojmë kujtimet e të tjerëve që vijnë pas nesh. Në këtë të ardhme ne përcaktojmë dhe kujtimet tona si shoqëri, rrugëtimin origjinal për në NATO dhe për Bashkim Evropian. Këtë rrugë duhet ta bëjmë ne si testament për gjenerata që vijnë, si mirënjohje për ato që s'janë më.

Rrugëtimi ynë si shtet krenar, me njerëz të jashtëzakonshëm e të ardhme të ndritshme do të vazhdojë, sepse ky rrugëtim s'ka kthim prapa. Sepse Kosova, atdheu ynë është i përhershëm. Sepse Republika e Kosovës është e përhershme dhe e pavdekshme.

Zoti e bekoftë Kosovën tonë të bukur! Njerëzit e saj punëtorë e të devotshëm, miqtë tanë dhe aleatët tanë të palëkundur! Zoti e bekoftë këtë ditë! Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Abdixhiku! Tani është radha e Grupit Multietnik, deputeti Artan Aslani.

ARTAN ASLLANI: E nderuara presidente zonja Osmani-Sadriu

I nderuar president, zoti Begaj,

E nderuar kryetare e Kuvendit, zonja Haxhiu,

I nderuar kryeministër Kurti,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të dashur kolegë deputetë,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

E nderuara Familja Jashari dhe Familja Haradinaj,

I nderuar Kor Diplomatik,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, në këtë ditë të shënuar për shtetin tonë, kujtojmë momente kur Kosova u shpall e pavarur pas një rruge të gjatë sakrifice, qëndrese dhe shprese. Pavarësia e Kosovës nuk ishte një akt i rastësishëm, e as një dhuratë. Ajo erdhi pas dekadash padrejtësi, vuajtje dhe përpjekje të përbashkëta. Ishte fitore e atyre që besuan se liria dhe dinjiteti janë të drejta që nuk falen, por që fitohen.

Në atë ditë historike, komunitetet që sot e përbëjnë Grupin Multietnik ishin të përfaqësuara me dinjitet dhe përgjegjësi. Ishin gjithsej 12. Boshnjakë ishin 4 deputetë, turq ishin 3 deputetë, ashkalinj ishin 3 deputetë, 1 egjiptian dhe 1 deputet i komunitetit rom. Të gjithë ishin aty, të gjithë e dhanë nënshkrimin e tyre. Të gjithë morën përgjegjësi historike për shtetin e ri në letra, por jo në histori.

Në histori ka momente kur një popull nuk pyetet sa është i madh, por pyetet se a është i bashkuar. Dhe, Kosova u bë bashkë pikërisht në momentet kur qytetarët e saj, shumicë dhe pakicë, vendosën të jenë një zë i vetëm për një shtetndërtim. Në atë ditë nënshkrimi nuk ishte vetëm një bojë, apo një ngjyrë në letër, por ishte një betim, ishte një përgjegjësi, ishte një premtim se ky shtet nuk do t'i përkasë njërit, por të gjithëve.

Ne e respektojmë dhe e mbrojmë fuqishëm luftën e pastër dhe çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse ajo na hapi rrugën e lirisë dhe e bëri të mundur që sot kjo të ndodhë, dhe ne jemi të bindur dhe besojmë në pafajësinë e krerëve të UÇK-së, që po mbahen padrejtësisht në Hagë.

Dhe, sot 18 vjet më vonë, ne dëshmojmë se ai premtim ende qëndron, sepse nga ajo ditë, sot, nesër, pasnesër dhe deri në përjetë, ne do të jemi ende këtu, aty ku kemi qenë gjithmonë, aty pa hezitime dhe pa kushte.

E këtu na lidh një gjë e vetme. Na lidh Kosova e përbashkët që e kemi. Kosova është vendi ku jetojmë të gjithë, ku rritim fëmijët tanë dhe ku e ndërtojmë të ardhmen tonë. Një shtet që synon një jetë më demokratike, më gjithëpërfshirëse dhe më të drejtë për çdo qytetar.

Dhe në këtë 18-vjetor të pavarësisë festojmë atë që kemi arritur të gjithë së bashku. Sepse liria fitohet vetëm një herë, por shteti ndërtohet përjetë.

Urime Ditën e Republikës së Kosovës! Zoti e bekoftë Kosovën dhe të gjithë qytetarët që jetojnë këtu! Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYTEARJA: Faleminderit, zoti Asllani! Tani është radha e AAK-së, zoti Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

E nderuara presidente e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu,

I nderuar, shumë i dashur dhe i respektuar president, mirë se ke ardhur, faleminderit që na ke nderuar me praninë tuaj!

Baca Rifat, faleminderit shumë që je me ne gjithmonë!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kryetare e Kuvendit,

Shumë të dashur familjarë të dëshmorëve,

Familje Rugova,

Ushtarë të FSK-së,

Oficerë të Ushtrisë më të lavdishme në glob të Shteteve të Bashkuara të Amerikës - Good Bless You, që jeni sot me ne,

Të nderuar ambasadorë, deputetë, kolegë,

Zonja dhe zotërinj,

Pa dyshim që shpallja e pavarësisë së Kosovës është një kurorëzim i një rezistence të gjatë, i një sakrifice të brezave dhe i një lufte historike për liri e për dinjitet. Ishte momenti kur ëndrra shekullore për liri e shtetësi u bë realitet politik dhe juridik që po e gëzojmë sot.

Më 17 Shkurt 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur, demokratik dhe multietnik, një akt që njëherë e përgjithmonë e vulosi vullnetin e popullit tonë për të jetuar të lirë në tokën e vet.

Sot, kur po e shënojmë ditëlindjen e 18-të të Republikës së Kosovës, dua t'u drejtohem gjeneratave të reja, dua t'u flas veçanërisht atyre vajzave dhe djemve, që këtë kohë mund të mos e kenë në përkujtimin e jetës së tyre.

Shpeshherë, një pjesë e madhe e tyre, lirinë që e gëzojmë sot, po e marrin si të mirëqenë, po mendojnë që është dashur të jenë të lirë. Jo, nuk është dashur të jenë të lirë. Liria dhe shtetësia, secili duhet ta dijë, kanë ardhur me një sakrificë të madhe, me një vetëmohim, me humbje të mëdha dhe me qëndresë të palëkundur të gjeneratave të këtij vendi dhe të këtij kombi.

Në këtë ditë të shenjtë, pa dyshim që përulemi me respekt të përjetshëm për sakrificën e atyre që kurrë nuk u ndalën duke besuar në liri. Është i gjatë vargu i patriotëve e patrioteve që punuan e luftuan ndër shekuj për këtë tokë.

Është i madh numri i atyre, që ndër breza e paguan me gjak lirinë tonë. I madh është edhe numri i aleatëve perëndimorë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që u bënë krah nesh në luftën për liri. Të një populli të vendosur për liri dhe shtetin e vet, me një armatë trimash dhe heronjsh, edhe ata të brezit të fundit, që nga Adem Jashari, Shkëlzen e Luan Haradinaj, Zahir Pajaziti, Fehmi e Xhevë Lladrovci, Agim Ramadani, e deri te luftëtari i fundit, të një populli që ende po sfidohet pse luftoi për lirinë e vet, duke u përballur me gjykime të padrejta.

Janë katër emra që janë simbol i lirisë: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, të cilët padrejhtësisht janë duke u ballafaquar me një proces, në të cilin pa dyshim do të shpallen të pafajshëm, për shkak se besojmë në luftën tonë të drejtë për liri, dhe besojmë në drejtësinë ndërkombëtare.

Në këtë përvjetor, kur i kemi mbushur 18 vjet, me respekt dhe pietet duhet ta kujtojmë edhe presidentin Ibrahim Rugovë, ta përkujtojmë Adem Demaçin. Dhe, të na kujtohet se është koha të flasim shumë qartë, shumë sqartë dhe drejtpërdrejt, për tri mrekulli kombëtare që e përbëjnë themelin e këtij shteti që e gëzojmë sot:

* E para, kurrë nuk duhet të harrojmë se vlera më e madhe historike, pas fitoreve të Skënderbeut, është vetë lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila solli çlirimin përfundimtar dhe lirinë që kurrë s'e kemi pasur të plotë në këtë tokë e në këtë vend;

* Mrekullia e dytë, është shpallja dhe njohja e pavarësisë së Kosovës si shtet i pavarur, demokratik dhe multi-etnik. Kjo është arritja më e madhe kombëtare shqiptare, për shkak se kjo tokë kurrë s'ka qenë e administruar prej shqiptarëve më herët dhe kurrë s'ka qenë më e lirë;

* E treta, mrekullia që duhet të realizohet, e cila nuk është realizuar plotësisht, është konsolidimi i plotë i shtetit tonë në organizmat ndërkombëtarë. Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, në

organizatat ndërkombëtare, në Këshillin e Evropës, në NATO, në të gjithë organizmat tjerë, në mënyrë që njëherë e përgjithmonë Kosova ta përmbyllë një cikël të rëndësishëm të popullit të vet.

Ky është një kapitull që duhet ta përmbylim me urtësi, me unitet politik, por edhe me vizion strategjik. Është çështje urgjente kombëtare që ta ndërtojmë një pakt politik të brendshëm, një unitet shoqëror për mbrojtjen e këtyre vlerave themelore.

Përbaltja dhe zhvlerësimi i luftës për liri, apo vetë aktit të pavarësisë së Kosovës dhe simboleve tona, nuk i shërben askujt. Duke cenuar këto themele dëmtojmë vetë kauzën tonë kombëtare e shtetërore dhe të ardhmen e brezave që po vijnë.

Zonja dhe zotërinj,

Kosova ka nevojë për unitet në çështje madhore. Por, ka nevojë edhe për institucione të forta, pasi pavarësia nuk është vetëm një akt historik, është përgjegjësi e përditshme për ne, për ta bërë një shtet më të drejtë, më të zhvilluar, shtet që i respekton më shumë të drejtat e njeriut dhe shtet i cili forcohet dhe anëtarësohet në arenën ndërkombëtare, gjithmonë krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët tanë perëndimorë.

Le të urojmë kujtesën historike, le të forcojmë shtetin tonë dhe ta çojmë Kosovën drejt integritetit të plotë euroatlantik.

Gëzuar 18-vjetori i Pavarësisë, Kosovë!

(Duartrokitje)

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar Tahiri!

Të nderuar të pranishëm,

Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe me këtë përmbyll punimet e kësaj seance solemne me rastin e kremtimit të 18-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*